



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA BULQIZË
KESHILLI BASHKIAK**

Nr. 267 prot

Bulqizë më 12 . 05 . 2018

VENDIM

Nr. 47 Datë 12.05 2018

PËR

**RIMIRATIMIN E DHËNIES SE BURSAVE TE SHTETIT PËR NXËNËSIT E VITEVE
II, III DHE IV TE SHKOLLES PROFESIONALE GJEOLGJI MINIERA NE
BASHKINE BULQIZE.**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, 19 e 28 të ligjit nr. 69/2012, «Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë », te ndryshuar, të pikes 2, nenit 32, të ligjit nr.15/2017 « Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë », ligjit nr.139 datë 17.12.2015 « Për Veteqeverisjen Vendore », të ligjit nr:130/2016 « Për buxhetin e vitit 2017 të ndryshuar », të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 753 prot.datë 13.12.2017, « Per kuotat financiare te ushqimit ne mensa e konvikte per percaktimin e kriterëve per perfitimin e bursave dhe pagesave per nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2017-2018», Urdherit Nr.658 date 27.12.2017, Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinise « Për planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e Arsimit Parauniversitar ne institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2017-2018,2016-2017, 2015-2016 , si dhe në VKB nr. 45 datë 19.12.2014, VKB nr. 35, datë 30.12.2015, VKB nr. 03, datë 20.01.2017, Keshilli Bashkiak ne mbledhien e tij te dates 12.05.2018 pasi diskutoi dhe analizoi rreth projekt vendimit te paraqitur nga drejtoria e arsimit dhe kultures prane bashkise me 13 vota pro, asnje kunder dhe asnje abstenim

VENDOSI

1. Të rimiratojë listën e përditësuar të nxënësve (33 nxënës nga 39 te miratuar ne 2014) që kanë përfituar bursë të plotë, sipas VKB nr. 45 datë 19.12.2014, dhe që ndjekin studimet në klasën e XIII në Shkollën e Mesme Profesionale Gjeologji Miniera Bulqizë.
2. Të rimiratojë listën e përditësuar të nxënësve (20 nxënës nga 30 të miratuar në 2015) që kanë përfituar bursë të plotë, sipas VKB nr. 35, datë 30.12.2015, dhe që ndjekin studimet në klasën e XII në Shkollën e Mesme Profesionale Gjeologji Miniera Bulqizë.

3. Të rimiratojë listën e përditësuar të nxënësve (38 nxënës nga 41 të miratuar në 2017) që kanë përfituar bursë të plotë, sipas VKB nr. 03, datë 20.01.2017, dhe që ndjekin studimet në klasën e XI në Shkollën e Mesme Profesionale Gjeologji Miniera Bulqizë.

Bashkëngjitur këtij Vendimi, relacioni dhe listat e përditësuara të nxënësve që ndjekin vitet II,III,IV në Shkollën Profesionale Gjeologji Miniera BULQIZE.

Ky vendim hyn ne fuqi pas konfirmimit nga prefekti i Qarkut Diber.

**SEKRETARI
AGIM TUCI**



PER KESHILLIN BASHKIAK



**KRYETARI
GAZMEND KENGA**



Dixhitalizuar ne kuader te projektit STAR II permes Qendres per Cheshtjet e Informimit Publik
www.inform.org
www.vendime.al